



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr 020-15908 /2025

Klinë, datë 27/01/2025

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, publikuar në Gazetën Zyrtare, më dt.04.06.2008, nr.28, dispozitat e nenit 11,12 dhe 15 të Ligjit për Planifikim Hapësinor, nr.04/L-174, dispozitat e nenit 12 të U.A të MMPH-së, nr.05/2014, dispozitat e U.A të MMPH-së nr.11/2015, nenit 91 të Statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010, më propozimin e Drejtorit të DUMM, Kryetari i Komunës së Klinës, mori këtë;

V E N D I M

Për formimin e komisionit për hartimin e Raportit të shqyrtimit publik
të Draft Planit Zhvillimor Komunal PZHK 2025-2033

1. **FORMOHET**, komisioni komunal për shqyrtimin e komenteve dhe hartimin e Raportit të Shqyrtimit Publik lidhur me dokumentin e planifikimit- Draft Planin Zhvillimor të komunës së Klinës (PZHK)2025-2033

Përbërja e komisionit do të jete si në vijim:

- | | | |
|------|----------------------|-------------|
| 1.1. | Klementina Qerkinaj | kryesues/e, |
| 1.2. | Altin Mujaj | anëtar, |
| 1.3. | Adem Sejdiu | anëtar, |
| 1.4. | Xhezide Trepça Gashi | anëtare, |
| 1.5. | Antonia Selmani | anëtarë, |

2. Komisioni mbledh, analizon komentet, propozimet e vërejtjet e marra gjate fazës së shqyrtimit publik dhe arsyeton miratimin apo refuzimin e tyre, si dhe harton Raportin e Shqyrtimit Publik brenda afateve te parapara.
3. Komisioni punën e vet e kryen ne baze të dispozitave të U.A të MMPH-së, nr.05/2014 për përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinorë, si dhe aktet tjera ligjore e nënligjore në fuqi qe rregullojnë këtë fushë.
4. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- Te përmendurit;
- Drejtoria e Urbanizmi;
- Kompania konsulentë;
- Zyrtarja përgjegjëse e konsultimeve publike, si dhe;
- Arkivi.



Kryetari,
Zenun Elezaj